

Zgjedhja e natyrshme



POMPA NGROHËSE
ME TEMPERATURË TË ULËT
DAIKIN ALTHERMA

Katër përfitimet e pompës ngruhëse me temperaturë të ulët Daikin Altherma


- x Kurseni në kostot e përdorimit duke ruajtur komoditetin optimal
- x Përshtatje e përkryer për shtëpitë e reja si dhe ato me konsum të ulët të energjisë
- x Zgjidhje kompakte për nxehjen e ujit për përdorim shtëpiak
- x Kontroll intuitiv dhe vetëshpjegues



Zgjedhja e natyrshme

3 në 1: ngrohje, ftohje dhe ujë i ngrohtë

Daikin Altherma është një sistem total ngrohjeje dhe uji të ngrohtë për përdorim shtëpiak me opsion për ftohje. Bazuar në teknologjinë e pompës ngrohëse, ai përfaqëson një alternative fleksibël dhe me kosto efikase ndaj sistemeve tradicionale të ngrohjes. Efikasiteti i trashëguar për kursimin e energjisë të Daikin Altherma, e bëjnë atë një zgjidhje ideale për të ulur konsumin e energjisë dhe për emetime të ulëta të CO₂.



Pompa ngrohëse Daikin Altherma përdor një burim energjie të qëndrueshme: nxjerrjen e nxehtësisë nga ajri i jashtëm. Në një qark të mbyllur që përmban ftohës të lëngshëm, krijohet një cikël termodinamik përmes avullimit, kondensimit, ngjeshjes dhe zgjerimit. Kjo "pompë" ngroh nga një nivel më i ulët temperature në një nivel më të lartë. Përmes një shkëmbyesi nxehtësie, nxehtësia transferohet në sistemin shtëpiak të shpërndarjes së ujit të nxehtë. Ky sistem mund të jetë nxehtë nën dysHEME, radiatorë me temperaturë të ulët ose ventilkonvektorë. Për ftohje, sistemi funksionon në të kundërt.

Sistem me efikasitet të lartë

Daikin Altherma mund të ngrohë shtëpinë deri me 5 herë më shumë efikasitet sesa një sistem tradicional ngrohjeje që bazohet në lëndët djegëse fosile ose energjinë elektrike, duke arritur një koeficient të shkëlqyer performance (COP) prej 5,04 *. Duke përfituar nga nxehtësia në ajrin e jashtëm, sistemi harxhon më pak energji ndërkohë që ju shijoni një nivel komforti të qëndrueshëm dhe të këndshëm. Gjithashtu, kërkesat për mirëmbajtje janë minimale, duke i mbajtur të ulëta kostot e përdorimit. Falë teknologjisë së përparuar të kompresorit, kursimet e energjisë janë edhe më të mëdha.

Llogaritni kursimet tuaja të energjisë. Shkoni te ecocalc.daikin.eu dhe shikoni vetë se sa mund të kurseni me një pompë ngrohëse Daikin.



* Simulim për një shtëpi të re të ndarë (dhomë me çati) me emetues të temperaturës së ulët, për 4 persona me një sipërfaqe ngrohjeje prej 125m², duke marrë në konsideratë kushtet klimatike të Belgjikës.

Kurseni në kostot e përdorimit duke ruajtur komoditetin optimal

Funksionim efikas në të gjitha kushtet

Teknologjia e përparuar e Daikin Altherma ofron si kursime të larta ashtu edhe temperaturë komode dhome. Kjo fillon me përmasat e duhura të komponentëve për shtëpinë tuaj, në mënyrë që të mos paguani për kapacitete të panevojshme. Në qendër të saj ndodhet një kompresor me efikasitet të lartë që prodhon rendiment maksimal me energji minimale.

Kontrolli inteligjent siguron përdorimin më efikas të energjisë në të gjitha stinët – edhe në mot shumë të ftohtë – duke mbajtur të ulëta kostot e përdorimit.

Shtoni edhe mirëmbajtjen minimale dhe vlerat e shkëlqyera për skemat kredituese për efikasitet në energji. Në total, instalimi i një Daikin Altherma ju rezulton në një përfitim të madh nga investimi i bërë.



Gjurmë e vogël


Me vetëm **600x728 mm**, njësia e brendshme e integruar për vendosje mbi dysheme Daikin Altherma kursen vend dhe kombinon një gjurmë të vogël me një dizajn elegant dhe kompakt.

Përshtatje e përkryer për shtëpitë e reja si dhe ato me konsum të ulët të energjisë

Një sistem i vetëm për komoditet optimal gjatë gjithë vitit

Po ndërtoni shtëpi të re? Po përmirësoni efikasitetin e energjisë të shtëpisë suaj ekzistuese? Sistemi Daikin Altherma është zgjidhja ideale. Ai gërsheton ngrohjen, ftohjen dhe ujin e ngrohtë për përdorim shtëpiak në një sistem, duke ofruar komoditet maksimal gjatë gjithë vitit. I përshtatshëm për të gjitha klimat, ai është i ndërtuar për t'u bërë ballë edhe kushteve më të egra të dimrit, duke siguruar temperatura të qëndrueshme dhome në të gjithë shtëpinë.

Edhe më shumë se kaq, sistemi mund të lidhet me të gjithë emetuesit e nxehtësisë me temperaturë të ulët në ndërtimet moderne të banimit. Këto përfshijnë ngrohjen nën dysheme, radiatorët me temperaturë të ulët, ventilkonvektorët dhe konvektorët e pompës ngrohëse.





Zgjidhje kompakte për nxehjen e ujit për përdorim shtëpiak

Nëse po kërkon një zgjidhje që i përfshin të gjitha, Daikin Altherma është përgjigja e duhur. Njësia e brendshme për vendosje mbi dysheme kombinon nxehjen dhe ftohjen me nxehjen e ujit të ngrohtë për përdorim shtëpiak. Ajo përbëhet nga një rezervuar me kapacitet të lartë prej 180 ose 260 litrash me 50% më pak humbje nxehtësie krahasuar me një rezervuar standard. Kontrolli inteligjent ofron një funksion për programim (nxehjen e rezervuarit në një kohë specifike të ditës) dhe një funksion rinxehjeje (rinxehje automatike kur temperatura bie nën një minimum të specifikuar).

Nëse nuk kërkohet ujë i ngrohtë i integruar për përdorim shtëpiak, shihni njësinë e brendshme Daikin Altherma për montim në mur në faqen 6.


Njësi për vendosje mbi dysheme që i përfshin të gjitha




Kontroll intuitiv dhe vetëshpjegues

Parametrat e përdoruesit mund të aksesohen përmes një ekrani të madh dhe një menyje intuitive dhe vetëshpjeguese. Ato përfshijnë programim të kohës për ngrohje, ftohje dhe ujë të ngrohtë në shtëpi. Kjo siguron temperatura të qëndrueshme dhome për komoditet më të lartë dhe temperaturat e duhura të ujit për përdorim shtëpiak, për efikasitet më të lartë. Meny të më të detajuara ofrojnë informacion dhe kontroll të mëtejshëm, si p.sh. menaxhim të përparuar të energjisë.

Në mënyrë alternative, një ekran i thjeshtësuar tregon vetëm temperaturën e dhomës dhe lejon që të ndryshohet pika e caktuar e temperaturës.





Njësi e montuar në mur

Njësi kompakte e brendshme me dizajn elegant

Njësi e brendshme Daikin Altherma e montuar në mur mund të jetë zgjidhja e përkryer, në disa situata. Brenda dizajnit të saj elegant dhe kompakt ndodhen të gjithë komponentët hidraulikë. Kjo njësi është e përshtatshme kur **nuk nevojitet uji i ngrohtë për përdorim shtëpiak i integruar me sistemin Daikin Altherma**; kur **njësi duhet të kombinohet me një rezervuar të veçantë për ujë të ngrohtë për përdorim shtëpiak**; ose kur **kërkohet një lidhje me sistemin diellor Daikin të ujit të ngrohtë**.



Kombinoni njësitë e montuara në mur me energjinë diellore

Kompleti i panelit diellor Daikin Altherma transferon nxehtësinë diellore te rezervuari i ujit të ngrohtë të Daikin Altherma përmes një shkëmbyesi të jashtëm të nxehtësisë. Kjo lejon që volumi i rezervuarit të ngrohet me efikasitet me nxehtësi diellore dhe, nëse është e nevojshme, me energjinë e pompës ngrohëse.

Falë një veshjeje të përparuar, panelet e transferojnë rrezatimin diellor në një mënyrë shumë efikase. Panelet mund të montohen në tjegullat e çatisë së ndërtesës. Si zgjidhje për gjithë vitin, kompleti përfshin lëndë kundër ngrirjes për të parandaluar ngrirjen gjatë dimrit. Ai mund të përdoret gjithashtu për të ngrohur shtëpinë duke përdorur ngrohjen nën dysheme.



Konvektor i pompës ngrohëse



Konvektori i pompës ngrohëse Daikin Altherma bën shumë më tepër sesa një ventilkonvektor ose emetues tjetër nxehtësie. Ai mund të ofrojë singrohjeedhe ftohje nëse kërkohet. Dhe i lidhur me sistem pompe ngrohëse Daikin Altherma ai jep efikasitet optimal energjie, duke kursyer në kostot e përdorimit.

Kombinuar me ngrohjen nën dysheme, konvektori i pompës ngrohëse është opsioni i përkryer. Përveç kësaj, në këtë konfigurim mund të përmirësohet efikasiteti me afërsisht 25% krahasuar me ventilkonvektorët normalë.

Shtëpitë e sotme me konsum të ulët të energjisë kanë nevojë për një emetues nxehtësie me reagim të shpejtë. Konvektori i pompës ngrohëse Daikin Altherma mund të përzgjidhet për ngrohje ose ftohje të shpejtë. Përfitimet shtesë përfshijnë përmasën kompakte, zhurmën shumë të ulët, instalimin e lehtë dhe kontrollin individual të dhomave me programues javor të kohës.





Daikin, partneri që ju zgjidhni

Certifikimi Solar Keymark



Panelet diellore të Daikin kanë fituar certifikimin Solar Keymark për produktet termike diellore i cili njihet në të gjithë Evropën dhe ndihmon përdoruesit të përzgjedhin panele cilësore diellore.

Në shumicën e vendeve evropiane, ky certifikim është i detyrueshëm që produktet të kenë të drejtën e fitimit të subvencioneve.



Sot, Daikin është lider në rrugën drejt zgjidhjeve të komoditetit më efikase, më ekonomike dhe më të padëmshme për mjedisin, duke prezantuar produkte të optimizuara për të gjitha stinët. Në fakt, produktet e Daikin reduktojnë energjinë dhe kostot në mënyrë inteligjente. Ato janë projektuar për të performuar në të gjitha kushtet dhe të reflektojnë performancën aktuale që mund të presësh pas një sezoni të tërë ngrohjeje dhe ftohjeje. Prandaj, me Daikin bëni zgjedhjen e duhur për portofolin tuaj... dhe për mjedisin.



Pozicioni unik i Daikin si prodhues i pajisjeve për kondicionimin e ajrit, të kompresorëve dhe freonëve, ka çuar në angazhimin e tij të drejtpërdrejtë në çështjet mjedisore. Për vite me radhë Daikin ka pasur si qëllim që të bëhet një lider në ofrimin e produkteve që kanë ndikim të kufizuar në mjedis. Kjo sfidë kërkon modele ekologjike dhe zhvillimin e një game produktesh dhe të një sistemi për menaxhimin e energjisë, të cilat rezultojnë në ruajtjen e energjisë dhe në zvogëlimin e mbetjeve.

Broshura aktuale është hartuar vetëm nëpërmjet informacionit dhe nuk përbën ndonjë ofertë detyruese për Daikin Europe N.V. Daikin Europe N.V. e ka hartuar përmbajtjen e kësaj broshure me njohuritë e saj më të mira. Nuk jepet asnjë garanci e shprehur ose e nënkuptuar për plotësinë, saktësinë, besueshmërinë ose përshtatshmërinë për qëllime të veçanta të përmbajtjes së saj dhe të produkteve dhe shërbimeve të paraqitura këtu. Specifikimet u nënshtrohen ndryshimeve pa njoftim paraprak. Daikin Europe N.V. refuzon në mënyrë të qartë çdo përgjegjësi për dëmtim direkt ose indirekt, në kuptimin më të gjerë, i cili lind ose lidhet me përdorimin dhe/ose interpretimin e kësaj broshure. E drejta e autorit për të gjithë përmbajtjen është e Daikin Europe N.V.



Produktet Daikin shpërndahen nga:

Daikin Airconditioning Central Europe Handelsmbh
 Campus 21, Europaring F12/402, A - 2345 Brunn am Gebirge
 Tel.: +43 2236 32557, Fax: +43 2236 32557-910
 E-mail: office@daikin-ce.com, www.daikin-ce.com